

EC MA NDRYSHE

"SADAFET"

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 18.11.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për restaurimit dhe rregullimit të ambientit përreth Memorialit të Dëshmorëve në Arbanë, mori këtë

### KONKLUZION


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e restaurimit dhe rregullimit të ambientit përreth Memorialit të Dëshmorëve në Arbanë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-48486  
Më 21.11.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-37940 të datës 11.7.2013, kryetari i Komunës, më 21 nëntor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Lejohen mjetet për mbështetje financiare të projektit të prezantuar të Qendrës për promovim, demokratizim dhe integrim (QPDI) nga Prizreni, i cili projekt ka të bëjë me monitorimin e punës së Kuvendit nga kjo Qendër për periudhën 9 mujore, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në lartësi prej 5000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-37940 të datës 11.7.2013.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 21.11.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugës “Elena Gjika”, me elemente të betonit, me sistem të participimit, mori këtë

### KON KLUZION


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 20.11.2013, për lejimin e ndërtimit të rrugës “Elena Gjika”, me elemente të betonit, me participim, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Mëja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-45759  
Më 13.11.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Austri dhe pagesës së mëditjeve për Fahrije Bytyqin, drejtoreshë e DPMS, kryetari i Komunës, më 13 nëntor 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Lejohet udhëtimi zyrtar i Fahrije Bytyqit, drejtoreshë e DPMS, për në Austri, me qëllim të pjesëmarrjes në vizitën studimore. Udhëtimi do të realizohet nga data 8 dhjetor deri me 10 dhjetor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurën.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

### Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-47777  
Më 19.11.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Çështje Gjinore, për lejimin e mjeteve financiare për organizimin e aktiviteteve me rastin e fushatës kundër dhunës ndaj Gruas, kryetari i Komunës, më 19 nëntor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Çështje Gjinore, për lejimin e mjeteve financiare për organizimin e aktiviteteve me rastin e fushatës kundër dhunës ndaj Gruas, e cila fushatë do të realizohet në periudhën prej datës 25.11.2013 deri me 10.12.2013, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare si në vijim:

- a. Për pagesë të ligjëruesit për tri ligjërata, lejohen mjete financiare në shumën 150 €,
- b. Për pagesë të një emisioni në radio Prizren, lejohen mjetet financiare në shumën 100€, dhe
- c. Për pagesë të broshurave, lejohen mjetet financiare në shumën 50 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoria e Administratës si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Maja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 19.11.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Billush, me sistem të participimit, mori këtë

### K O N K L U Z I O N


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 19.11.2013, për lejimin e ndërtimit të rrjetit të kanalizimit fekale në fshatin Billush, me participim, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-46236  
Më 14.11.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Durrës dhe pagesës së mëditjeve për Islam Elshanit, zyrtar komunal për komunitete, kryetari i Komunës, më 14 nëntor 2013, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Islam Elshanit, zyrtar komunal për komunitete, me qëllim të pjesëmarrjes në takimin që ka të bëjë me fuqizimin e kapaciteteve të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian për të promovuar në mënyrë aktive dhe efektive në nivel qendror dhe lokal. Takimi organizohet nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur –KFOS dhe i njëjti do të mbahet nga data 15 nëntor deri me 17 nëntor 2013 në Durrës të Republikës së Shqipërisë, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

### Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, i lartcekuri, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muija

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-zyrtar  
Më 18.11.2013

Kryetari i Komunës, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për vendosjen e mbishkrimeve në Memorialin e Dëshmorëve në Arbanë, mori këtë

### KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e vendosjes së mbishkrimeve në Memorialin e Dëshmorëve në Arbanë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

